| II-286                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit dhe Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, mbi dërgimin e disa ekzemplarëve të statutit të rekrutimit, që nevojiten për dikasteret e ndryshme.   | 03.05.1929                    | 1                      |
| II-287                 | Qarkore, drejtuar prefekturave dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare dhe Oborrit Mbretëror, mbi çrregullimet e zyrave të Shtetit Civil e të rekrutimit.   | 01.09.1929 - 02.08.1929       | 9                      |
| II-288                 | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, mbi dhënie oferte një personi për t'u marrë vesh me të birin që është në Argjentinë, i cili kërkohet për të kryer shërbimin ushtarak.   | 07.16.1929 - 09.07.1929       | 3                      |
| II-289                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Ministrit të Punëve të Brendshme me Kryesinë e Këshillit të Ministrave etj, mbi rekrutët që nuk dihet vendbanimi.  | 04.09.1929 - 09.08.1929       | 3                      |
| II-290                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit dhe Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, mbi kërkesën për lirimin e djalit nga ushtria, si dhe lutje e një personi që mos të merret si rezervist.  | 03.18.1929 - 11.21.1929       | 9                      |
| II-291                 | Lutje e një personi, drejtuar Mbretit për të sqaruar mbi punën e ushtrisë në lidhje me disa djem që shkojnë ushtarë dhe disa të tjerë që nuk shkojnë.  | 11.02.1929                    | 2                      |
| II-292                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit, Pallatit Mbretëror dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, mbi sigurimin e rojeve të zyrave dhe ligj mbi rregullimin e Rojes Mbretërore të Kufirit.   | 02.12.1929 - 12.04.1929       | 20                     |
| II-293                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, mbi veprimet e Marinës Luftarake.   | 05.04.1929 - 06.07.1929       | 5                      |
| II-294                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit, Pallatit Mbretëror dhe Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, mbi kërkesën e disa personave për mostransferimin e disa reparteve në vend tjetër.  | 09.09.1929 - 09.13.1929       | 11                     |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>   | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|--|-------------------------------|------------------------|
| II-295                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit dhe Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, mbi dërgimin e një ushtrie në postën kufitare për të kontrolluar pasaportat e personave që kërkojnë kufirin.  | 04.13.1929 - 08.07.1929       | 4                      |
| II-296                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme, mbi arratisjen e disa oficerëve dhe dorëzimin tek autoritetet.   | 05.19.1929 - 10.29.1929       | 17                     |
| II-297                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Komandës së Mbrojtjes Kombëtare dhe Kryesisë së Këshillit të Ministrave, mbi dhënien e një sasive materiali ushtrisë për ta përparuar për punë të ndryshme, si dhe formimin e një komisioni për blerjen e veshmbathjeve për Ushtrinë Mbretërore.                 | 07.25.1929 - 10.20.1929       | 4                      |
| II-298                 | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Jashtme, mbi fortifikacionet dhe materialet ushtarake, që transporton qeveria jugosllave në Kufirin Shqiptar.   | 08.03.1929 - 08.13.1929       | 3                      |
| II-299                 | Ligj, projektligj dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Financave, mbi blerjen e rrobave ushtarake.   | 03.14.1929 - 04.19.1929       | 9                      |
| II-300                 | Telegram dhe korrespondencë ndërmjet Kryeministrit me Oborrin Mbretëror, mbi kërkesën e një personi për t'iu dhënë sipërmarrja e punimit të këpucëve të gjindarmëve, si dhe shtimi dyfish i druve dhe i qymyrit për Baronin e Gardës.  | 01.10.1929 - 12.29.1929       | 9                      |
| II-301                 | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Ministrit të Financave, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare etj, mbi ndërrimin e këpucëve të mëdha me këpucë të vogla, si dhe mbi gjobën për vonesën e dorëzimit të mallit mos të aplikohet se do të jetë bërë ndonjë gabim. | 04.01.1929 - 06.22.1929       | 10                     |
| II-302                 | Dekretligj dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit e Oborrit Mbretëror, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare etj, mbi dorëzimin e armëve të mbledhura nga populli, si dhe transportimi i tyre.  | 02.15.1929 - 03.27.1929       | 29                     |
| II-303                 | Korrespondencë ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Departamentit Ushtarak, Ministrit të Ekonomisë Kombëtare etj, mbi administrimin e depos së rritjes së kuajve të ushtrisë.   | 05.27.1929 - 05.30.1929       | 4                      |
| II-304                 | Dekretligj, mbi ushqimin e përditshëm të oficerëve.  | 03.21.1929 - 05.31.1929       | 14                     |
| II-305                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Pallatit Mbretëror dhe Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi dërgimin e listave që përmbajnë emrat e personave, që do të shkojnë në Itali në Shkollën e Karabinierëve.   | 07.30.1929 - 11.07.1929       | 9                      |



| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>  | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|---|-------------------------------|------------------------|
| II-306                 | Qarkore, procesverbal, lista dhe korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Financës, Departamentit Ushtarak, mbi pjesëmarrjen e nëpunësve në Shkollën e oficerëve rezervë. | 02.01.1929 - 12.31.1929       | 83                     |
| II-307                 | Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Pallatit Mbretëror, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare etj, mbi dërgimin e listave emërore të nëpunësve që ju shtohen stërvitjes ushtarake, si dhe mbi organizimin dhe veprimin e mësimeve paraushtarake.                           | 01.14.1929 - 10.21.1929       | 87                     |
| II-308                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Pallatit Mbretëror me Komandën e Mbrojtjes Kombëtare dhe Kryesinë e Këshillit të Ministrave, mbi dërgimin e emrave të oficerëve, që shkojnë jashtë shtetit me misionet, për studim dhe me leje.                                     | 06.18.1929                    | 4                      |
| II-309                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Pallatit Mbretëror dhe Kryesisë së Këshillit të Ministrave, mbi prishjen e llogarive që ndodhen në kufi me Jugosllavinë dhe njoftim i qeverisë jugosllave që të mosshkaktojnë ngjarje të pakënaqshme me ushtarët që do i prishin.   | 08.22.1929 - 09.12.1929       | 4                      |
| II-310                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare dhe Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë, mbi ndalimin e oficerëve të huaj në tokën tonë pa lejkalimi.  | 07.16.1929 - 08.02.1929       | 7                      |
| II-311                 | Korrespondencë ndërmjet Pallatit Mbretëror, Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, mbi lejimin e fluturimit të aeroplanit francez në tokën shqiptare.   | 06.03.1929 - 08.08.1929       | 7                      |
| II-312                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komandës së Fuqisë Armate etj, mbi lënien e lirë të oficerëve grekë për të vizituar disa qytete të Shqipërisë afër kufirit, si dhe çelje e një kredie për mirëpritjen e tyre.     | 01.08.1929 - 04.06.1929       | 8                      |
| II-313                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Oborrit Mbretëror, mbi lejimin e Komandantit të Follorinës për të ardhur në Bilisht.   | 11.08.1929 - 11.22.1929       | 7                      |
| II-314                 | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, Ministrisë së Punëve të Brendshme etj, mbi dhënien e informatave për përgatitjen e jugosllavëve për të sulmuar në Shqipëri.   | 01.09.1929 - 07.22.1929       | 30                     |
| II-315                 | Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, Pallatit Mbretëror etj, mbi rregullat që do të ndiqen për atashetë ushtarakë të huaj, si dhe rregulla mbi mbledhjen e lajmeve.  | 06.15.1929 - 09.23.1929       | 19                     |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>   | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|--|-------------------------------|------------------------|
| II-480                 | Korrespondencë e Kryeministrit me Komandën e Mbrojtjes Kombëtare, mbi pengesat që hasën nga dikasteret në lidhje me lëshimin e kuadrit, për kryerjen e shërbimit ushtarak.   | 10.29.1929                    | 1                      |
| II-481                 | Njoftim dhënë Kryeministrit mbi emërimin e Alberto Parianit, Drejtor i Departamentit Ushtarak.   | 03.09.1929                    | 1                      |
| II-493                 | Dekretligj dhe korrespondencë e Kryeministrit me Kryesinë e Parlamentit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punëve të Brendshme etj. mbi zbatimin dhe hyrjen në fuqi më 1 gusht 1928 të ligjit mbi organizimin e Intendencës së Përgjithshme të Fuqisë Armate. | 02.20.1929 - 02.23.1929       | 0                      |
| <b>III</b>             | <b>Ekonomi-Financë</b>   |                               |                        |
| III-857                | Vendim i Këshillit të Ministrave, qarkore e korrespondencë mbi paradhëniet që ju jepen nëpunësve e institucioneve për nevoja të ndryshme.  | 01.25.1926 - 10.27.1929       | 35                     |
| III-1114               | Dekretligj (kopje), projekt, raport, vendime dhe korrespondenca përkatëse mbi lidhjen e marrëdhënieve tregtare me Amerikën, Britaninë e Madhe, Francën, Hungarinë, Japoninë, Austrinë etj.   | 11.04.1927 - 03.28.1929       | 59                     |
| III-1132               | Ligj mbi përjashtimin nga taksa doganore e oktrovës makinat e veglat që do të importojnë shoqëria sipërmarrëse për punime botore, si dhe vendime, raport justifikues dhe korrespondenca përkatëse.   | 03.13.1927 - 01.03.1929       | 29                     |
| III-1160               | Pasqyra mbi të ardhurat të kompetencës së ushtrimit 1927-1928.   | 12.15.1929                    | 34                     |
| III-1250               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë së Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Sekretarinë e Oborit Mbretëror në lidhje me kërkesën për dhënie ndihmë financiare për shkak të gjendjes së keqe ekonomike.          | 09.28.1928 - 01.29.1929       | 11                     |
| III-1259               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve Botore mbi formimin e një shoqërie mbi shërbimin e transportimeve.   | 12.19.1928 - 01.04.1929       | 4                      |
| III-1306               | Projektligj dhe raport mbi shërbimin shëndetësor të veterinarisë.  | 12.17.1928 - 01.19.1929       | 51                     |
| III-1308               | Projektligj dhe raport mbi seleksionimin e lopëve dhe pelave.  | 12.17.1928 - 01.15.1929       | 25                     |
| III-1342               | Vendim, lutje dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Doganave mbi emërimin, pushimin dhe transferimin e personelit të doganës.   | 01.08.1928 - 01.02.1929       | 106                    |
| III-1374               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi përjashtimin nga taksa doganore të teshave që nevojiten për djemtë gjurmues.  | 01.05.1929 - 01.10.1929       | 4                      |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>   | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|--|-------------------------------|------------------------|
| III-1375               | Korrespondencë e Kryeministrit me Oborrit Mbretëror, Komanda e Përgjithshme e Fuqisë Armate mbi përjashtimin nga taksa doganore e materialit të luftës.  | 10.28.1928 - 04.23.1929       | 23                     |
| III-1377               | Dekretligj, projekt mbi dekretligjin për përjashtimin nga taksa doganore të misrit ,si dhe korrespondenca përkatëse.   | 02.02.1928 - 03.09.1929       | 84                     |
| III-1381               | Lutje e një personi ku kërkohet përjashtimi nga taksa doganore të sendeve që ka sjellë nga Italia, si dhe korrespondenca përkatëse.  | 11.30.1928 - 03.07.1929       | 11                     |
| III-1384               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve Botore, Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Postë -Telegrafeve, etj. mbi emërime, pushime, transferime dhe gradime të punonjësve të Postë Telegraf Telefonave. | 01.09.1928 - 02.27.1929       | 358                    |
| III-1394               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, Sekretarinë e Oborrit Mbretëror, etj., mbi emërime, pushime, transferime, gradime të personelit të Ministrisë së Financave.  | 12.28.1927 - 01.02.1929       | 401                    |
| III-1395               | Ligj dhe projektligj mbi shtimin e një organizatori në buxhetin e Ministrisë së Financave.   | 11.19.1928 - 03.16.1929       | 10                     |
| III-1401               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Këshillin Kontrollues mbi aktgjykimin e llogaritit të financës për mosmbajtjen në rregull të dokumenteve.  | 12.21.1928 - 11.11.1929       | 13                     |
| III-1404               | Ligj, dekretligj, projektligj, vendim i Këshillit të Ministrave mbi dhënie akordim dhe transferim kredie dhe korrespondenca përkatëse.   | 01.14.1928 - 04.16.1929       | 278                    |
| III-1405               | Ligj, projektligj, dekretligj dhe vendime të Këshillit të Ministrave mbi mbartjen dhe transferimin e fondeve në buxhet, si dhe raporti dhe korrespondenca përkatëse.   | 01.26.1928 - 07.13.1929       | 149                    |
| III-1406               | Ligj dhe dekretligj mbi paraqitjen e buxhetit të Komandës së Përgjithshme të Fuqisë Armate, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, si dhe korrespondenca përkatëse.  | 11.14.1928 - 11.09.1929       | 24                     |
| III-1408               | Projektligj dhe raport mbi plotësimin e një kapitulli në buxhetin e viteve 1928 - 1929 të gjindarmërisë.   | 03.28.1929 -                  | 4                      |
| III-1409               | Dekretligj për çeljen e Kap. 69 në buxhetin e ushtrimit 1928 - 1929 të Ministrisë së Financave me emërim shpenzimesh për llotarinë e shtetit.  | 03.28.1929                    | 5                      |
| III-1428               | Lutje dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, Sekretarinë e Oborrit Mbretëror mbi kundërshtimin e vendimit të dhënë prej gjyqit për anulimin e kontratës së lagrit të peshkut.   | 10.11.1928 - 01.03.1929       | 6                      |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>  | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|---|-------------------------------|------------------------|
| III-1431               | Projektligj mbi taksat e të drejtat e limaneve.   | 11.19.1928 - 01.21.1929       | 25                     |
| III-1433               | Vendime të Këshillit të Ministrave, projektligj mbi të dhjetën e katundarëve, si dhe korrespondenca përkatëse.  | 08.31.1928 - 07.05.1929       | 31                     |
| III-1438               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe lutja mbi zbritjen e taksës të topjakut, si dhe korrespondenca përkatëse.  | 12.12.1928 - 01.15.1929       | 12                     |
| III-1444               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit etj. mbi gjobitjen e personave të ndryshëm.   | 01.26.1928 - 01.02.1929       | 33                     |
| III-1449               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi dorëzimin e një shume të hollash në arkën e financës në kohën e duhur.   | 03.15.1929                    | 2                      |
| III-1455               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, Pallatin Mbretëror mbi dërgimin e listës dhe urdhërave të pagesës që i përkasin ushtrimit financiar 1928-1929.  | 12.19.1929 - 12.27.1929       | 4                      |
| III-1460               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Këshillin Kontrollues, Ministrinë e Punëve Botore, Komandën e Përgjithshme të Fuqisë Armate mbi lëshimin e mandatpagesave në lidhje me rrogat e nëpunësve civil. | 01.03.1928 - 01.31.1929       | 54                     |
| III-1461               | Projekt mbi dekretligjin mbi dhënien e shpërblimeve ushtarakëve, si dhe korrespondenca përkatëse.   | 01.14.1928 - 04.18.1929       | 40                     |
| III-1462               | Ligj, projekt mbi dekretligjin, vendime të Këshillit të Ministrave, lutje mbi dhënien e shpërblimeve personave të ndryshëm, si dhe korrespondenca përkatëse.  | 01.09.1928 - 06.04.1929       | 124                    |
| III-1463               | Lutje dhe vendime të Këshillit të Ministrave mbi dhënien e shpërblimeve patriotike si dhe korrespondenca përkatëse.   | 02.01.1928 - 06.11.1929       | 79                     |
| III-1466               | Lutje dhe korrespondencë e Kryeministrit me Komandën e Përgjithshme të Fuqisë Armate, Ministrinë e Punëve të Brendshme, sekretarinë e Oborrit Mbretëror mbi dhënien e pensioneve ushtarake.   | 03.08.1928 - 01.10.1929       | 52                     |
| III-1468               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, Komandën e Përgjithshme të Fuqisë Armate, Komandën e Mbrojtjes Kombëtare mbi shpenzime rroge të personelit ushtarak.   | 03.27.1928 - 03.03.1929       | 44                     |
| III-1471               | Dekretligj, vendime të Këshillit të Ministrave dhe lutje mbi shpenzime udhëtimi e dietë si dhe korrespondencë përkatëse.  | 07.02.1927 - 01.08.1929       | 104                    |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>   | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|--|-------------------------------|------------------------|
| III-1473               | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi dhënien paradhënie për persona të ndryshëm për nevoja të ndryshme si dhe korrespondenca përkatëse.  | 01.03.1928 - 1929             | 387                    |
| III-1475               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi shpenzimet e bëra për blerjen e një shtëpie që banon legata shqiptare në Athinë.  | 12.15.1928 - 01.11.1929       | 2                      |
| III-1477               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Financave mbi akordimin e përqindjeve titullarëve të kryekonsullatave.                                 | 10.19.1928 - 03.27.1929       | 6                      |
| III-1479               | Ligj, projektligj dhe raport mbi transferim kredie në buxhetin e Ministrinë e Punëve të Brendshme.   | 01.26.1929 - 02.27.1929       | 15                     |
| III-1482               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, Komandën e Përgjithshme të Fuqisë Armate etj. mbi shpenzimet e bëra për blerjen e disa sendeve të nevojshme për ushtrinë. | 02.16.1928 - 01.03.1929       | 110                    |
| III-1487               | Dekret dhe vendime të Këshillit të Ministrave mbi shpenzime për blerje toke si dhe korrespondenca përkatëse.   | 02.25.1928 - 06.07.1929       | 22                     |
| III-1489               | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi shpenzimet për blerjen e kafshëve si dhe korrespondenca përkatëse.  | 11.12.1927 - 01.04.1929       | 58                     |
| III-1492               | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi shpenzimet e bëra për udhëtime, meremetime si dhe korrespondenca përkatëse.   | 01.15.1928 - 01.04.1929       | 139                    |
| III-1494               | Projektligj, projekt mbi dekretligjin mbi të prapambeturit pa fond të degës botore.  | 05.26.1928 - 01.12.1929       | 10                     |
| III-1496               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Këshillin Kontrollues, Ministrinë e Punëve Botore mbi pranimin e disa dokumenteve për likuidimin definitiv të shpenzimeve.                          | 11.03.1928 - 02.04.1929       | 10                     |
| III-1498               | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi shpenzimet e bëra për sipërmarrësit në lidhje me disa punë që kanë bërë si dhe korrespondenca përkatëse.  | 01.14.1928 - 02.28.1929       | 21                     |
| III-1500               | Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, sekretarinë e Oborrit Mbretëror në lidhje me shpenzimet që ka patur arka e shtetit nga importimi i disa sendeve.   | 10.09.1928 - 04.09.1929       | 6                      |
| III-1501               | Dekret dhe vendime të Këshillit të Ministrave mbi shpenzimet e bëra për shtypjen, ngjitjen, vënien e tyre në qarkullim dhe mënyrën e shitjes të pullave postare, si dhe korrespondenca përkatëse.                          | 03.01.1928 - 11.18.1929       | 131                    |
| III-1502               | Korrespondencë e Kryeministrit me Drejtorinë e Përgjithshme të Postë Telegraf Telefonave mbi shpenzimet e bëra për telegramet që janë dërguar jashtë shtetit.  | 02.28.1929                    | 4                      |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>  | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|---|-------------------------------|------------------------|
| III-1505               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe lutje mbi pagim qiraje si dhe korrespondenca përkatëse.  | 10.22.1927 - 02.01.1929       | 44                     |
| III-1507               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave, sekretarinë e Oborrit Mbretëror për shpenzime zyre.  | 01.03.1928 - 07.02.1929       | 43                     |
| III-1517               | Projektligj, raport dhe vendime të Këshillit të Ministrave mbi shpenzimet e bëra për dhënie burse si dhe korrespondenca përkatëse.  | 02.15.1928 - 01.03.1929       | 125                    |
| III-1527               | Lutje dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi shlyrjen e borxheve ndaj shtetit dhe personave.  | 10.13.1928 - 12.04.1929       | 6                      |
| III-1529               | Lutje dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, sekretarinë e Oborrit Mbretëror në lidhje me ankimet e personave për çështjen e një gardhi dhe toke.  | 08.28.1928 - 04.22.1929       | 2                      |
| III-1538               | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi njohje pronësie të personave të ndryshëm si dhe korrespondenca përkatëse.  | 01.16.1928 - 05.17.1929       | 35                     |
| III-1540               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi dhënien e titrave të zotërimit të jetimëve të A. Vokopolës.   | 12.04.1928 - 04.18.1929       | 2                      |
| III-1542               | Vendime të Këshillit të Ministrave, lutje dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Komandën e Mbrojtjes Kombëtare, Komandën e Përgjithshme të Fuqisë Armate, Prefekturën e Shkodrës mbi shpronësimin dhe mosshpronësim tokash, oborresh dhe kopshtesh. | 02.08.1928 - 06.28.1929       | 82                     |
| III-1545               | Korrespondencë e Kryeministrit me Nënprefekturën e Tepelenës në lidhje me dërgimin e disa statistikave mbi lëkundjet e tërmetit në rrethin e Tepelenës.   | 08.13.1929                    | 52                     |
| III-1546               | Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit me Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare mbi emërimin në punë të personelit të Ekonomisë Kombëtare, si dhe ndryshim rrogash të kuadrit të kësaj ministrie.   | 04.30.1929 - 07.22.1929       | 10                     |
| III-1548               | Raport të inspektorive të përgjithshme të administratës dhe të Oborrit Mbretëror mbi inspektimin që është bërë në prefekturat Elbasan, Korçë dhe në nënprefekturat e tyre vartëse.  | 10.21.1929                    | 72                     |
| III-1549               | Raport tremujor mbi veprimet e Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare.   | 04.04.1929                    | 9                      |
| III-1551               | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi marrjen e një shume të hollash si ndihmë popullit.   | 09.17.1929 - 09.24.1929       | 3                      |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>   | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|--|-------------------------------|------------------------|
| III-1552               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë mbi marrjen në shërbim me kontratë të nënshtetasve të huaj si specialistë, si dhe ndihma e mbrojtja që i duhet dhënë nga qeveria jonë specialistëve të huaj.                                     | 01.03.1929 - 01.27.1929       | 95                     |
| III-1553               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi vështirësitë që hasin shoqëritë sipërmarrëse italiane në Shqipëri për gjetjen e punëtorëve nga shkaku i pagave shumë të ulta. | 10.05.1929 - 11.27.1929       | 13                     |
| III-1555               | Vendime të Këshillit të Ministrave, lutje dhe korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare mbi dhënien e një dëmshpërblimi Vasil Argjiropullit për shfrytëzimin e pyllit të Divjakës.   | 05.03.1929 - 06.26.1929       | 5                      |
| III-1556               | Kopje e dekretit mbi aprovimin dhe zbatimin e statusit të shoqërisë " Puka Sisma " (minerale).   | 06.10.1929 - 12.19.1929       | 92                     |
| III-1557               | Dekretligj mbi përmirësimin e Art.3 të ligjit mbi monopolizimin e vajgurit, benzinës, etj., si dhe lidhje e kontratës në mes të Qeverisë Shqiptare dhe shoqërisë "Agip ".  | 01.29.1929 - 12.02.1929       | 110                    |
| III-1558               | Projektligj mbi zbatimin e afatit të dytë të kërkimeve të shoqërisë koncesionare të vajgurit " D'Aruj Apleracion CITD ", si dhe raport lidhur me këtë problem.   | 04.27.1929 - 11.27.1929       | 29                     |
| III-1559               | Projekt mbi shtojcë ligjin e konvencionit të koncesionit të dytë për kërkime e shfrytëzim të vajgurit dhënë hekurudhave të Shtetit Mbretëror Italian, si dhe akordim leje përfaqësuesve të hekurudhave për të bërë kërkime për vajguri.                | 09.23.1929 - 12.04.1929       | 13                     |
| III-1560               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe propozim i Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare mbi formimin e një komisioni teknik mbi shikimin e punimeve të kërkimeve të vajgurit nga shoqëri të ndryshme.  | 03.23.1929 - 04.18.1929       | 2                      |
| III-1561               | Konvencion për mbledhjen dhe punimin e rrënjës së bimës së shqopës, si dhe vendim, procesverbal dhe korrespondencë mbi vendimin e arbitrazhit për koncesionin e rrënjës së shqopës.  | 02.25.1929 - 05.10.1929       | 12                     |
| III-1566               | Dekret Mbretëror mbi ndryshimin e statutit të shoqërisë " Gjeneral elektrik" të Korçës, si dhe korrespondenca përkatëse lidhur me këtë problem.  | 03.11.1929 - 04.09.1929       | 13                     |
| III-1567               | Dekret mbi aprovimin e statutit të shoqërisë anonime të elektrikut të Pogradecit, si dhe modifikimin e disa neneve të statutit.  | 07.09.1929 - 09.19.1929       | 26                     |
| III-1568               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve mbi drurët e zjarrit që kërkon për të prerë shoqëria " Sifa ".  | 02.08.1929                    | 2                      |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>   | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|--|-------------------------------|------------------------|
| III-1569               | Adjudikatë për dhënien në koncesion të monopolit të artikujve eksplozivë.  | 1929                          | 4                      |
| III-1570               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave mbi konditat për koncesionin e shfrytëzimit të ujrave të Prefekturës së Shkodrës dhe Nënprefekturës së Lezhës e Shëngjinit.      | 04.24.1929 - 09.03.1929       | 7                      |
| III-1571               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve Botore mbi dhënien në koncesion të sistemimit të lumit të Kirit, si dhe vaditjen me ujë të disa fushave. | 04.02.1929 - 04.20.1929       | 4                      |
| III-1572               | Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Financave etj. mbi pasuritë natyrore që mund të jepën në koncesion kapitalistëve amerikanë.                                     | 02.27.1929 - 03.22.1929       | 7                      |
| III-1573               | Konvencion i lidhur ndërmjet shoqërisë Serbo - Kroato - Sllovene dhe Republikës Shqiptare për kërkime arkeologjike.  | 1929                          | 8                      |
| III-1574               | Lutje e disa personave drejtuar Këshillit të Ministrave mbi moslejimin e instalimit të një shtypshkronje nga shoqëria e huaj.  | 08.24.1929                    | 2                      |
| III-1575               | Dekret mbi aprovimin e statutit të shoqërisë anonime për zhvillimin e shtypit e të artit tipografik me emrin " Tipart ".   | 03.22.1929 - 08.10.1929       | 55                     |
| III-1576               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Shtetit mbi dërgimin e statutit të shoqërisë anonime " Vincenzo Rocco ".  | 12.21.1929 - 12.31.1929       | 3                      |
| III-1577               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, etj. mbi ndryshimin e statutit të shoqërisë " Stamles ".   | 03.11.1929 - 06.01.1929       | 8                      |
| III-1578               | Vendime të Këshillit të Ministrave si dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Shtetit mbi disa ndryshime në statutin e shoqërisë anonime " Banka Tregtare e Shqipërisë ".       | 04.25.1929 - 05.28.1929       | 8                      |
| III-1579               | Dekret mbi aprovimin e ndryshimit të nenit të 9-të të statutit të shoqërisë anonime " Maliq " si dhe procesverbalin dhe korrespondencë lidhur për këtë problem.  | 04.19.1929 - 10.31.1929       | 26                     |
| III-1580               | Aktshtesë kapitali dhe modifikimi i statutit të shoqërisë " SAIB ".  | 11.19.1929                    | 2                      |
| III-1581               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare mbi ateljerin e sixhadeve të shoqërisë " Dele ".   | 04.05.1929                    | 1                      |



| Numri i dosjeve | Titulli  | Viti (Filluar-Mbaruar)  | Sasia e fletëve |
|-----------------|--|-------------------------|-----------------|
| III-1582        | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi çështjen e kripës me shoqërinë " Sila " mbi mosplotësimin e kontratës për monopolizimin e kripës, si dhe formimin e një komisioni për demituar arkën e shtetit dhe korrespondencë e lidhur me këtë problem.                         | 02.27.1929 - 11.26.1929 | 14              |
| III-1584        | Vendim i Këshillit të Ministrave mbi pezullimin e punimeve të shoqërisë sipërmarrëse " Socco " dhe shëmbjen e punimeve të kryera nga ato në dëm të shoqërisë, si dhe ti referohet gjyqit për falsifikimin që kanë bërë në libra dhe korrespondenca përkatëse.              | 10.23.1929 - 12.31.1929 | 4               |
| III-1588        | Letër e shoqërisë " Krahu " drejtuar Mbretit që të merren masat për shpëtimin e industrisë nga konkurenca.   | 08.06.1929              | 2               |
| III-1589        | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Punëve Botore me Kryesinë e Këshillit të Ministrave mbi akordim leje për ngritjen e një stacioni hidro - elektrik.  | 04.22.1929 - 07.29.1929 | 15              |
| III-1590        | Lutje e personave sipërmarrës të mullinjve të vajit drejtuar Kryeministrisë dhe korrespondencë me Ministrinë e Punëve të Brendshme ku kërkojnë ndalimin e ndërtimit të fabrikës për blerjen e ullinjve në Elbasan nga shoqëri franceze sepse rrezikohet kapitali shqiptar. | 07.24.1929 - 11.06.1929 | 6               |
| III-1592        | Projektligj dhe raport mbi privatizimet industriale.   | 02.20.1929 - 03.29.1929 | 9               |
| III-1593        | Dekretligj mbi modifikimin e artikujve 2, 3 e 12 të ligjit "Mbi pijen alkoolike ".   | 09.04.1929 - 11.16.1929 | 12              |
| III-1594        | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve mbi dhënie leje për kërkime për thëngjill guri.  | 10.16.1929 - 11.02.1929 | 15              |
| III-1595        | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi dhënien e lejes bashkë me armët, pesë rojtarëve të kripores.  | 07.10.1929 - 07.13.1929 | 2               |
| III-1596        | Vendim, dekretligj, raporte, rregullore mbi detyrat dhe specializimin e personelit të bujqësisë (agronom, veterinari, pyje etj.) dhe kërkesë për të hyrë në punë.  | 01.05.1929 - 12.31.1929 | 656             |
| III-1597        | Ligj mbi policinë bujqësore (policia bujqësore dhe detyrat e saj), ligj i dëmeve.  | 02.15.1929 - 04.24.1929 | 36              |
| III-1598        | Projektligj mbi reformat agrare dhe mbi organizimin e drejtorisë, si dhe vendime, korrespondencë dhe raport i Profesor Giovanni Lorenzoni mbi " Reformën Agrare " në Shqipëri.   | 04.22.1929 - 11.30.1929 | 153             |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>   | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|--|-------------------------------|------------------------|
| III-1599               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Financave, Kryesisë së Parlamentit, Kryeministrisë etj. mbi marrjen pjesë në komisionin për përgatitjen e ligjit mbi Reformën Agrare.   | 08.12.1929 - 11.30.1929       | 8                      |
| III-1600               | Dekretligj mbi detyrimin e punimit dhe mbi krijimin e katundeve tipe në qarkun e Nënprefekturës së Kavajë.   | 09.19.1929 - 10.03.1929       | 15                     |
| III-1601               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbi telegramin e At Aleks Sema e Vangjel Poli, përfaqësues të bujqëve të Neshat Pashës, ku kërkojnë sigurimin e të drejtave e të qetësisë së bujqëve të disa katundeve të Prefekturës së Vlorës. | 01.15.1929 - 03.02.1929       | 11                     |
| III-1602               | Ligj mbi rregullimin e veprimeve bujqësore.  | 02.21.1929 - 02.26.1929       | 12                     |
| III-1603               | Kontrata tip për t'u adaptuar si bazë midis pronave dhe bujqëve.   | 11.21.1929                    | 5                      |
| III-1604               | Ligj mbi shkëmbimin e disa tokave shtetërore me tokë private në Lushnjë, si dhe raport dhe korrespondencë lidhur me këtë problem.  | 01.30.1929 - 03.20.1929       | 10                     |
| III-1610               | Ligj mbi konkurse diftimi (mostra), panogjyrë (fiera) e ekspozicione, raport dhe korrespondencë lidhur me këtë problem.  | 03.16.1929 - 04.30.1929       | 15                     |
| III-1611               | Ligj si shtojcë e ligjit mbi mbjelljen e detyrueshme të frutshme, si dhe raport e korrespondencë lidhur me këtë problem.   | 02.02.1929 - 02.27.1929       | 10                     |
| III-1612               | Ligj mbi dhënie e farës pemë dhe fidanëve popullit, si dhe korrespondencë lidhur me këtë problem.  | 02.19.1929 - 12.11.1929       | 9                      |
| III-1613               | Raport mbi gjendjen bujqësore dhe mbi gjënë e gjallë të qarkut të Gjirokastrës, si dhe korrespondencë lidhur me këtë problem.  | 02.08.1929 - 03.22.1929       | 17                     |
| III-1614               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi gjendjen e misrit.  | 05.25.1929 - 06.11.1929       | 7                      |
| III-1615               | Ligj mbi ndalimin e përhapjes së sëmundjeve ndër bimë, drithë, etj., si dhe korrespondencë lidhur me këtë problem.   | 02.04.1929 - 05.01.1929       | 21                     |
| III-1616               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave me Ministrinë e Punëve Botore mbi ndërtimin e stacionit zooteknik në Selenicë nga sipërmarrësi A. Simonidhi - Tomburlimi Monai.   | 12.11.1929 - 12.27.1929       | 2                      |
| III-1617               | Ligj mbi seleksionimin e detyrueshëm të pelave e të lopës, si dhe korrespondencë mbi thellimin e funksionimin e depos së rritjes së kafshëve të ushtrisë.  | 03.20.1929 - 05.22.1929       | 27                     |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>  | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|---|-------------------------------|------------------------|
| III-1618               | Korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Oborrit Mbretëror mbi dorëzimin e 60 armëve, barinjve në bazë të nenit 7-të të ligjit më datë 11 korrik 1928.  | 11.20.1929 - 11.29.1929       | 3                      |
| III-1619               | Korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare, Kryesisë së Këshillit të Ministrave dhe Departamentit Ushtarak mbi kafshët e ngarkesës.  | 09.24.1929                    | 4                      |
| III-1620               | Ligj mbi shërbimin veterinar, si dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Kryeministrisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare mbi ndalimin e importit të dhive.  | 02.16.1929 - 05.16.1929       | 40                     |
| III-1621               | Kërkesa të personave të ndryshëm drejtuar Kryeministrisë për akordim fondi nga ana e saj për çështje pyjesh, si dhe korrespondencë lidhur me këtë problem.  | 01.02.1929 - 12.21.1929       | 26                     |
| III-1622               | Vendim i Këshillit të Ministrave mbi marrjen e masave për rritjen e krimit të mëndafshit.   | 01.22.1929 - 02.11.1929       | 6                      |
| III-1623               | Ligj mbi dhënien farë mëndafshi popullit, si dhe korrespondenca përkatëse.  | 02.06.1929 - 02.19.1929       | 6                      |
| III-1624               | Vendim i Këshillit të Ministrave mbi ftesën që i bën Legata Italiane, Qeverisë sonë për të marrë pjesë në Konferencën Ndërkombetare Diplomatike për mbrojtjen e fidanëve që ka për të mbajtur Instituti Ndërkombëtar i Bujqësisë në Romë.   | 03.05.1929 - 03.09.1929       | 2                      |
| III-1626               | Vendim i Këshillit të Ministrave, si dhe korrespondencë e zhvilluar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Ekonomisë Kombëtare mbi njoftimin e emrit të shefit që do të marrë pjesë në mbledhjen që do të mbahet në Paris nga shoqëria " Couseil - International de la Casse ".                         | 07.02.1929 - 07.08.1929       | 3                      |
| III-1627               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryeministrisë, Ministrisë së Punëve Botore, Ministrisë së Financave, etj. mbi emërimet, transferime, pushime, gradime, dekorime të personelit të Ministrisë së Punëve Botore, si dhe dërgimi i biografive të tyre.                                  | 12.07.1928 - 11.29.1929       | 147                    |
| III-1628               | Ligj organik i Ministrisë së Punëve Botore dhe rregullore mbi caktimin e detyrave të personelit kontabël të Ministrisë së Punëve Botore.  | 12.31.1928 - 04.09.1929       | 11                     |
| III-1629               | Projektligj mbi sigurimin botues.   | 05.02.1929 - 06.05.1929       | 8                      |
| III-1632               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Punëve Botore, Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Oborrit Mbretëror mbi ndërtimin e linjave dekovile, blerja e materialeve dhe vaporëve që duhen për ngarkim - shkarkim, si dhe ngritja e pentitit të drurit për limanin e Durrësit. | 04.20.1929 - 09.12.1929       | 15                     |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>  | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|---|-------------------------------|------------------------|
| III-1633               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Ministrisë së Punëve Botore dhe prefekturave mbi lutjen e disa personave që mos të mbahen me shumë se ditët e caktuara për të punuar në hapjen e rrugëve, si dhe marrja pjesë në hapjen e rrugëve të personave që marrin misër gratis.  | 03.23.1929 - 09.27.1929       | 14                     |
| III-1634               | Vendime të Këshillit të Ministrave mbi ftesën që i bën Legata Italiane dhe Amerikane Qeverisë sonë për të marrë pjesë në Kongresin Internacional të Shtëpive dhe Planeve të qyteteve, si dhe në mbledhjen e Shoqërisë Ndërkombëtare të Përherëshme të Kongreseve mbi Rrugët, që do të mbahet në Washington.   | 03.19.1929 - 08.22.1929       | 5                      |
| III-1635               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe lutje e pleqësisë së katundeve Gur i Zi, Juban mbi lënien e lirë nga detyrimi me punime për faj të mos çrregjistrimit.   | 01.16.1929 - 03.29.1929       | 10                     |
| III-1636               | Lutje e Kryepleqësisë së Nënprefekturës së Peqinit dhe korrespondencë ndërmjet Ministrisë së Punëve Botore me Kryesinë e Këshillit të Ministrave mbi kërkesën për shpërnguljen e urës nga Rrogozhina në Peqin dhe mosmarrje parasysh e kësaj kërkesë.   | 02.18.1929 - 04.16.1929       | 7                      |
| III-1637               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave e Ministrisë së Punëve Botore mbi dërgimin e disa personave për të kontrolluar ndërtimin e urave.  | 10.03.1929 - 10.23.1929       | 8                      |
| III-1638               | Ligj mbi numrin e ndërtesave dhe rrugëve.   | 02.25.1929 - 04.06.1929       | 12                     |
| III-1639               | Vendim i Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave me Ministrinë e Punëve Botore mbi përgatitjen e një plani për sjelljen e ujit të pishëm, si dhe punimet që duhen kryer.  | 09.21.1929 - 12.27.1929       | 6                      |
| III-1640               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Departamentit Ushtarak, Ministrisë së Punëve Botore mbi lidhje kontrate dhe formimi i një komisioni për të caktuar vendin dhe studjuar projektin e ndërtimit të gazermave depo dhe shtablore që nevojiten për ushtrinë dhe dorëzimin e këtyre ndërtimeve. | 01.09.1929 - 12.03.1929       | 21                     |
| III-1641               | Vendime të Këshillit të Ministrave dhe korrespondencë ndërmjet Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Punëve Botore mbi marrje masash për ngritjen e ndërtesave qeveritare.   | 03.29.1929 - 05.14.1929       | 6                      |
| III-1642               | Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Komandës së Mbrojtjes Kombëtare dhe shoqërisë " Gruaja Shqiptare " mbi caktim vendi për ngritje ndërtesash.   | 12.05.1928 - 07.11.1929       | 10                     |

| <b>Numri i dosjeve</b> | <b>Titulli</b>  | <b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b> | <b>Sasia e fletëve</b> |
|------------------------|---|-------------------------------|------------------------|
| III-1643               | Korrespondencë ndërmjet Kryeministrit, Ministrit të Punëve të Brendshme mbi marrje masash dhe moslejimin e ngritjes së godinave në vende ku nuk lejohet.  | 07.03.1929                    | 1                      |
